



KONTROLLI I LARTË I SHETIT KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 04-228485

Nr. 343/6 Prot.

Tiranë, më 16/11/ 2016

V E N D I M

Nr. 141, Datë 16.11.2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHMË TË THESARIT, ME OBJEKT "AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË SË AKTIVITETIT TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit, ku jepet një pamje e rezultateve të auditimit të kryer sipas programit të auditimit nr. 643/1, datë 13.06.2016, me objekt "Për auditimin e përputhshmërisë dhe ligjshmërisë së aktivitetit të thesarit në përputhje me rregullat e menaxhimit financiar dhe buxhetit për vitin 2015", arrijmë në përfundimin se, me gjithë përpjekjet dhe punën e madhe të evidentuar për modernizimin dhe rritjen e performancës së sistemit të thesarit, u konstatuan shkelje e parregullsi në funksionimin e tij, kryesisht të lidhura me autorizimin e kryerjes së pagesave, regjistrimin e transaksioneve financiare, si dhe pasqyrimin e tyre në llogaritë e konsoliduara të shtetit. Në këto kushte është domosdoshmëri marrja e masave ligjore dhe organizative nga Ministria e Financave me qëllim që: Të rritet mbikqyrja e veprimeve që kalojnë përmes Sistemit të Thesarit, të funksionojë filtri në ekzekutimin e pagesave dhe transaksioneve që kryen nëpërmjet sistemit të tij, duke parandaluar dhe mos lejuar pagesa të cilat nuk janë të rregullta nga ana financiare apo në kundërshtim me kuadrin ligjor.

Sa më sipër, dhe në vlerësim të projektvendimit të paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit dhe Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt "Për auditimin e përputhshmërisë dhe ligjshmërisë së aktivitetit të thesarit në përputhje me rregullat e menaxhimit financiar dhe buxhetit për vitin 2015".

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQL.

1. Nga auditimi u konstatua se, rregullimi i veprimtarisë së Sistemit të Thesarit, si fushë e rëndësishme e menaxhimit të financave publike bëhet bazuar në ndonjë nen të Ligjit nr. 8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në RSH” (i shfuqizuar), neni 38, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” dhe Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 6, germa (ç) dhe neni 16 i tij.

Sistemi i Thesarit është krijuar me VKM nr.183, datë 16.04.1993 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të thesarit”, bazë ligjore që e ka humbur koherencën rregullatore të saj, referuar ndryshimeve që ka pësuar ndër vite Sistemi i Thesarit. Kjo konstatohet dhe me Udhëzimet e Ministrit të Financave të nxjerra gjatë viteve, të cilat kanë reflektuar nevojën për rishikimin dhe zhvillimin e kuadrit ligjor të sistemit, si Udhëzimi nr.3486, datë 02.09.2005 “Procedurat e punës në sistemin e thesarit dhe marrëdhëniet me institucionet buxhetore”, Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të sistemit të thesarit”, i ndryshuar, etj.

Në vitin 2015 dhe gjatë vitit 2016, nuk ka ndryshime të rregulloreve dhe manualeve të brendshme, të cilat vijojnë që nga viti 2010-2012, apo dhe më herët. Kjo mungesë e rregullave të plota sjell hapësira për veprime jo korrekte apo mundësi për abuzime.

Pra, konstatohet se funksioni dhe veprimtaria e thesarit, bazohen pikërisht tek VKM-ja nr.183, datë 16.04.1993, pa mundur që Sistemi i Thesarit në RSH të ketë një kuadër rregullator të plotë dhe të përditësuar të veprimtarisë së tij, ku të përcaktohen qartë objektivi i veprimtarisë, të drejtat dhe detyrimet, marrëdhëniet me palët, si për institucionet buxhetore dhe Bankat e nivelit të dytë dhe me Bankën e Shqipërisë. Konstatohet se e gjithë veprimtaria bazohet në aktmarrëveshje me to, ku konstatohet qartazi epërsia e të drejtave të Bankës së Shqipërisë në këto marrëdhënie, *trajtuar më hollësisht në faqe 10-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Me qëllim, që, e gjithë veprimtaria e Sistemit të Thesarit, të ketë një kornizë ligjore, bazuar në rregulla të qarta dhe pa interpretime, për shkak të natyrës specifike të tij dhe një procesi kompleks të financave të shtetit, që mbart në vetvete;

Me qëllim, rritjen e mbikëqyrjes së veprimeve që kalojnë përmes Sistemit të Thesarit, dhe funksionimin e një filtri në ekzekutimin e pagesave dhe transaksioneve që kryen nëpërmjet sistemit të tij, duke parandaluar dhe mos lejuar pagesa të cilat nuk janë të rregullta nga ana financiare apo në kundërshtim me kuadrin ligjor,

Nga ana e DPTH në bashkëpunim me Ministrinë së Financave të punohet për hartimin e një projektligji për funksionimin e Sistemit të Thesarit në RSH. Projektligji të jetë rregullator i veprimtarisë së thesarit, të përcaktojë qartë objektin e veprimtarisë, të drejtat dhe detyrimet, kompetencat, marrëdhëniet me palët, si për institucionet buxhetore, me Bankat e nivelit të dytë dhe me Bankën e Shqipërisë.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi konstatohet se, vetëm Rregullorja e Ministrisë së Financave përcakton në vija qendrore objektivat dhe detyrat që ka Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në këtë ministri, por nga kjo drejtori, ky mision dhe këto detyra nuk janë të renditura dhe të përcaktuara qartazi në

një manual të brendshëm për drejtorinë në përgjithësi dhe për çdo drejtori e sektor brenda saj, si dhe Degët e thesarit në rrethe.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit nuk kemi një rregullore të veçantë, ajo funksionon në bazë të rregullores së brendshme të MF si pjesë e saj, ndërkohë që procesi i punëve që kryen është specifik. Nga auditimi konstatohet se çdo sektor ka përshkruar një renditje të punëve, bazuar në përvojën dhe procesin e përditshëm që kryen, por që nuk janë të miratuara nga strukturat përgjegjëse në MF.

Nga auditimi konstatohet se, nuk ekzistojnë në asnjë rast gjurmët e auditimit, lidhur me miratimin e likuiditetit, miratimin e mënyrës së llogaritjes së tij, kërkesat për likuiditet nga Drejtoria e Borxhit nuk janë të dokumentuara dhe të rakorduara.

Në asnjë rast nuk kemi shkëmbim zyrtar shkresor brenda Drejtorisë së thesarit, sidomos për ato raste të cilat është i nevojshëm miratimi dhe konfirmim i shifrave i çeljeve vjetore, mujore apo ditore, i nivelit të likuiditetit etj, në kundërshtim me nenin 24 të Kodit Etik të Sistemit të Thesarit, miratuar me shkresën nr.117/2, datë 09.06.2011 dhe të kërkesave të Ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, “Kontrolli i brendshëm” qëllimi i të cilit është krijimi i një sistemi të varur kontrolli të brendshëm, i cili siguron që informacioni i gjeneruar nga Thesari të jetë i saktë dhe i besueshëm, që transaksionet të jenë të autorizuara dhe mjetet të jenë të menaxhuara me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet. Krijimi i këtyre procedurave ndihmon në zbulimin e hershëm dhe pakësimin e risqeve të lidhura me procedurat e Thesarit dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi, *trajtuar më hollësisht në faqe 10-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga ana e DPTH në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Financave (Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit) të hartohet një manual, ku të përcaktohen misioni dhe detyrat, përgjegjësitë e çdo niveli, veçanërisht të jetë e përcaktuar mënyra e komunikimit midis strukturave, ku për aspekte të veçanta vendimmarrëse si, miratimi i likuiditetit, miratimin e mënyrës së llogaritjes së tij, kërkesat për likuiditet nga Drejtoria e Borxhit, apo dhe çdo proces tjetër i cili kërkon miratim nga struktura përgjegjëse, të jenë të dokumentuara në formë shkresore.

Në manual, të jenë të renditura dhe të përcaktuara qartë, përshkrimi dhe renditja e punëve, mbi procesin e përditshëm që duhet të kryej çdo punonjës i thesarit, për drejtorinë në përgjithësi dhe për çdo drejtori e çdo sektor brenda saj, si dhe Degët e thesarit në rrethe, i miratuar ky nga strukturat përgjegjëse në MF.

Menjëherë

2. Nga auditimi i pagesave u konstatua se në muajin janar 2016 janë kryer pagesa gjithsej në shumën 6 miliardë lekë, ose 7.5% të totalit të pagesave vjetore, të cilat kanë kaluar për llogari të vitit 2015. Nga auditimi i këtyre pagesave në sistemin informatike të qeverisë(SIFQ) rezulton se janë kryer pagesa jashtë afatit të përcaktuar në udhëzimin e *Ministrit të Financave nr. 33, datë 28.12.2015 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2015”*, pra të regjistruara dhe të likuiduara në vitin 2016. Konkretisht, rezultuan se janë të tilla 25 transaksione në total në vlerën 79.553.961 lekë, ku peshën më të madhe e zënë veprimet në Degën e Thesarit Tiranë, në Degën e Thesarit Elbasan ,të cilat janë përfshirë në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, pavarësisht se janë regjistruar jashtë periudhës 1 janar-31 dhjetor.

Theksojmë se në udhëzimin e mësipërm, pika 17 përcaktohet se: “Bazuar në fondet buxhetore në dispozicion, nëpunësit autorizues të njëjstive të qeverisjes së përgjithshme do të urdhërojnë kryerjen e shpenzimeve në degët e thesarit deri në fund të ditës së punës, më 31.12.2015. Dega e Thesarit kryhen kontrollet sipas legjislacionit në fuqi lidhur me vlefshmërinë e fondeve dhe ekzistencën e dokumentacionit që provon shpenzimin e ndodhur dhe të marrë në dorëzim brenda datës 31.12.2015 (fatura e furnitorit duhet të jetë gjeneruar brenda dhjetorit 2015)”, ndërsa në pikën 18 thuhet: Në rastet kur institucioni provon shpenzimin e ndodhur

gjatë muajit dhjetor 2015 (fatura sipas pikës 17) brenda kufirit të fondeve disponibël, por procedurat e marrjes në dorëzim të shërbimeve apo të punimeve të kryera zgjasin përtej datës 31.12.2015, atëherë dega e thesarit pranon njohjen dhe regjistrimin në SIFQ të shpenzimeve për llogari të vitit 2015. Regjistrimi i faturave duhet të përfundojë dhe të kryhet rakordimi përfundimtar me institucionin sipas afatit të caktuar në pikën 21 të këtij udhëzimi”, ku është përcaktuar data 15.01.2016. Pra regjistrime të tilla çojnë në denatyrimin e konceptit “buxhet vjetor” dhe raportimit financiar vjetor. trajtuar më hollësisht në faqe 19-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, në **llogarinë 231** “Shpenzime për rritjen e AQT”, kemi pagesave për punime në infrastrukturë në të njëjtin moment me lidhjen e kontratës, kështu në **18 raste në vlerën 695 milion lekë**, (të cilat kryesisht i përkasin ARSH-s) janë likuiduar situacione të cilat janë pretenduar si punime të kryera, por në fakt, ato nuk mund të jenë të tilla, pasi diferenca kohore midis lidhjes së kontratës dhe likuidimit të situacionit është edhe vetëm 3 ditë, ku teknikisht është e pamundur, referuar manualeve teknike të ndërtimit, si dhe në kundërshtim me ligjin e prokurimeve dhe ligjin për Buxhetin e Shtetit.

Nga auditimi u konstatua se, në sistem evidentohen raste të çlirimit të garancisë së punimeve (5%) nga llogaria 466 “Garanci të punimeve” në një afat të shkurtër kohor, pasi është kryer marrja në dorëzim e punimeve, në kundërshtim me legjislacionin për punimet e ndërtimit. Referuar këtij legjislacioni dhe kontratave, garancia e punimeve çlirohet mbas një viti apo dy viteve në rastin e punimeve në segmente rrugore, me marrjen e certifikatës së difekteve gjatë periudhës së garancisë lëshuar nga institucioni përkatës, trajtuar më hollësisht në faqe 19-27 dhe aneksi nr.2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi lidhur me respektimin e procedurave të radhës së prioriteteve të pagesës, konstatohet se nuk jemi në kushtet e mungesës së likuiditetit dhe referuar rregullit hyrje e parë dalje e parë, pra kush hyn i pari (regjistrohet) në sistemin e pagesave likuidohet i pari, nga grupi i auditimit u morën me përzgjedhje pagesat e një tremujori (Tetor-Dhjetor) dhe duke respektuar një tolerancë minimumi prej 4 ditësh që duhet të kryhet pagesa, u konstatua se në 2045 transaksione, në shumën 6 miliard e 28 milion lekë evidentohen ekzekutime të pagesave me vonesë mbi minimumin e mësipërm dhe **deri mbi 6 muaj**, edhe pse janë regjistruar në sistem më herët se pagesat e tjera, trajtuar më hollësisht në faqe 19-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, të merren masa të menjëhershme që të ndërpriten praktika të tilla pagesash, me qëllim që të kemi vija të qarta si në raportimin e buxhetit vjetor por dhe të raportimit financiar për veprimtarinë vjetore duke u bërë pengesë në kalimin e veprimeve të cilat gjykohen jo në përputhje me legjislacionin, pavarësisht nga përgjegjësia për veprimin.

Nga ana e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave të kryhet verifikimi i pagesave të menjëhershme me lidhjen e kontratës, në **18 raste në vlerën 695 milion lekë**, (të cilat kryesisht i përkasin ARSH-s) ku janë likuiduar situacione të cilat janë pretenduar si punime të kryera, por, diferenca kohore midis lidhjes së kontratës dhe likuidimit të situacionit është edhe vetëm 3 ditë, ku teknikisht është e pamundur, referuar manualeve teknike të ndërtimit, si dhe në kundërshtim me Ligjin e prokurimeve dhe ligjin për Buxhetin e Shtetit.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave të merret në analizë dhe të nxirren arsyet, përgjegjësitë dhe personat përgjegjës lidhur me ekzekutimin të pagesave me vonesë dhe **deri mbi 6 muaj**, të 2045 transaksione në shumën 6 miliard e 28 milion lekë, në një kohë që sistemi i thesarit ka punuara në kushtet e një likuiditeti të bollshëm.

Menjëherë

4. Nga auditimi mbi procedurat e monitorimit financiar, evidentimit dhe menaxhimit të gabimeve në regjistrimin e transaksioneve, konstatohet se për vitin 2015, kemi 1893 raste gabimesh në regjistrimin e transaksioneve nga degët e thesarit nëpër rrethe.

Në total numrin më të madh të rasteve me gabime e zë Tirana me 62% rasteve, Berati me 2.7%, Durrësi me 5.8%, Fier me 2.4%, Gjirokastrë me 2.9%, Dibër me 2.5%, Sarandë me 3.1%, Mallakastër me 2.3 %, ndërkohë degët e tjera rezultojnë me gabime nën 2% të rasteve.

Risku i gabimit është në nivel të lartë dhe kjo është shoqëruar me kosto shtesë, pasi për çdo transaksion të kryer gabim për faj të punonjësve të Thesarit apo dhe institucionit, i paguhet Bankës respektive komision bankar, referuar rasteve të cilat janë të shumta për vitin 2015, gabimet kryesisht rezultojnë në, nr llogarie, përshkrime të pagesës etj. Në rastet e referuara nuk evidentohet qartë se gabimi i kujt është, i subjektit apo i punonjësit të thesarit, por rezultati është se faturimi i pagesës së komisionit gjithmonë është në ngarkim të Ministrisë së Financës dhe MF ja përcjell Degës përkatëse të thesarit dhe kjo e fundit Institucionit.

Për sa ndodh më sipër, nuk ka asnjë analizë për të përcaktuar dhe ndarë gabimin, në një gabim të mundshëm njerëzor, apo risk operacional i kapaciteteve të ulta të stafit, si dhe ndarja e përgjegjësisë për pagesën e komisionit, faturimi i të cilës duhet ti bëhet shkaktarit të saj, *trajtuar më hollësisht në faqe 19-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga ana e DPTH të merret në analizë situata e gabimeve të ndodhura në regjistrimin e transaksioneve, nga degët e thesarit, për të përcaktuar dhe ndarë gabimin, në një gabim të mundshëm njerëzor, apo risk operacional i stafit, si dhe të bëhet ndarja e përgjegjësisë për pagesën e komisionit, faturimi i të cilës duhet ti bëhet shkaktarit të saj.

Menjëherë dhe vazhdimisht

5. Nga auditimi konstatohet se, për vitin 2015 në llogaritë e Thesarit gabohet në regjistrimin e shpenzimeve. Regjistrime të gabuara në sistem, të cilat nuk lejojnë të mbyllet sistemi (të kalojë veprimi në ditar) dhe të kalohet në veprimin pasardhës në 29 raste, për të cilët është ndërhyrë për sistemin nga Drejtoria e Procesimit të Biznesit.

Sistemime me ditar të veprimeve të brendshme të kërkuara nga tatimet, gjithsej në 80 raste, ku peshën më të madhe të tyre e zë Drejtoria e Thesarit, Tiranë.

Sistemimet e pagesave me bankë (shpenzimet), ku konstatohet se numri total i gabimeve në vitin 2015 është në 1427 raste, ku Tirana paraqitet me 804 raste, ose 56 % kundrejt totalit, Vlora me 101 gabime, Shkodra me 94 raste, Durrës me 42 raste, Fier 43 raste Gjirokastrë 61 raste, etj.

Konstatohet se, nga pothuajse të gjithë punonjësit e Degës së Thesarit Tiranë, janë kryer sistemime të veprimeve, kryesisht në muajin dhjetor, *trajtuar më hollësisht në faqe 19-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga ana e DPTH të merret në analizë dhe të nxirren konkluzionet dhe arsyet e gabimeve sistematike në regjistrimin e shpenzimeve për çdo degë thesari dhe në veçanti për degën e thesarit Tiranë.

Menjëherë dhe vazhdimisht

6. Nga auditimi në llogarinë 466 “Garancitë e kontratave” u konstatua se, në dy raste çlirim garancish, të cilat nuk janë përballuar nga kjo llogari, por nga llogaria ekonomike 231 “Shpenzime për rritjen e AQT”, dhe llogaria 602 “Shpenzime operative”, konkretisht me transaksionin e datës 23.11.2015 nga Autoriteti Rrugor Shqiptar është paguar operatori ekonomik “B...” në shumën 821 mijë lekë, përballuar nga llogaria 602 “Shpenzime operative”, ndërsa më transaksionin e datës 31.12.2015 nga Drejtoria e Metrologjisë dhe Kalibrimit është paguar subjekti “R.....” në shumën 9 milion 456 mijë lekë për çlirimin e garancisë së kontratës pa numër identifikimi në sistem, ku këto fonde janë përballuar nga

llogaria ekonomike 231 “Shpenzime për rritjen e AQT”, (*sipas përshkrimit shuma e mësipërme i përket vetëm 50% të vlerës së garancisë së punimeve*), ndërkohë që duhet të përballoheshin nga llogaria 466.

Konstatohet se në sistemin informatik të qeverisë nuk hidhen të gjithë të dhënat e kërkuara (edhe pse nuk e pengojnë punën e sistemit) si, përshkrimi i saktë, data e kontratës, nr i kontratës etj., çka nuk të jep një pamje të plotë të transaksionit për monitorimin e mëtejshëm të veprimit, *trajtuar më hollësisht në faqe 19-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga ana e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave të merren në analizë të dy rastet e çlirimit të garancive, të cilat nuk janë përballuar nga llogaria 466 “Garancitë e kontratave”, por nga llogaritë ekonomike 231 dhe 602, në transaksionin e datës. 23.11.2015 nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, në shumën 821 mijë lekë, përballuar nga llogaria 602 “Shpenzime operative”, ndërsa më transaksionin e datës 31.12.2015 nga Drejtoria e Metrologjisë dhe Kalibrimit, në shumën 9,456 mijë lekë për çlirimin e garancisë së kontratës pa nr. të identifikuar në sistem, ku këto fonde janë përballuar nga llogaria ekonomike 231 “Shpenzime për rritjen e AQT” (*sipas përshkrimit shuma e mësipërme i përket vetëm 50% të garancisë së punimeve*), të bëhen korrigjimet e nevojshme së bashku me dy institucionet për llogaritë përkatëse.

Nga ana e DPTH të merren masa të menjëhershme dhe të mos kryhet asnjë pagesë në rast se në sistemin informatik të qeverisë nuk hidhen të gjithë të dhënat e kërkuara lidhur me transaksionin që kryhet, si, përshkrimi i saktë, data e kontratës, nr i kontratës etj, me qëllim monitorimin e mëtejshëm të veprimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

7. Nga auditimi i *diferencave të raportimit për të ardhurat e kaluara nga Bankat e nivelit të dytë* dhe raportimit që bëjnë këto banka në të dy institucionet (MOF dhe BOA), gjatë konfirmimit të këtij zëri si pjesë e llogarisë së unifikuar të thesarit “Depozitë Qeverie”, rezultoi:

a. Për vitin 2015, diferenca e raportimit e të ardhurave të njohura dhe kaluara nga Bankat e nivelit të dytë, është në vlerë **1,099,228 mijë lekë**, e përbërë nga:

- Diferenca acruall prej 1,095,298 mijë lekë, (rezultat i krahasimit të acruallit të datës 05.01.2015 për llogari të vitit 2014 prej 2,019,967.99 mijë lekë, me acruallin e datës 05.01.2016 për llogari të vitit 2015, prej 924,669.87 mijë lekë);
- Të ardhurat nga AECH, në vlerë 3,930.66 mijë lekë, shuma të regjistruara në sistemin e Bankës së Shqipërisë me zë më vete “Të tjera të ardhura vetëm nga AECH”, ndërsa në sistemin informatik të qeverisë (SIFQ), këto shuma kalojnë automatikisht në degët përkatëse të Thesarit dhe nuk shfaqen të veçanta në sistem.

b. Sipas ligjit organik të buxhetit, rregjistrimi dhe njohja e të ardhurave tatimore, jo tatimore, përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e aktiveve, bëhet në çastin e arkëtimit të tyre, ndërsa rregjistrimi dhe njohja e shpenzimeve korrente dhe kapitale të vitit buxhetor, bëhet në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës. Pra sipas këtij ligji, njohja dhe derdhja e të ardhurave buxhetore nga Bankat e Nivelit të dytë, është e ndryshme nga njohja dhe rregjistrimi i shpenzimeve buxhetore në këto banka (diferenca rregjistrimi dhe njohjeje midis të ardhurave dhe shpenzimeve cash&acruall).

Sipas Drejtorisë së Operacioneve të Thesarit në Ministrinë e Financës, rregjistrimi dhe njohja e të ardhurave nga bankat e nivelit të dytë, nga sistemin informatik i qeverisë (SIFQ), mund të realizohet njësoj si njohja dhe rregjistrimi i shpenzimeve, sepse sistemi (SIFQ) është i programuar edhe për të ardhurat.

c. Rregjistrimi i të ardhurave dhe shpenzimeve që kalojnë nga Bankat e nivelit të dytë në sistemin informatik të qeverisë (SIFQ), është i ndryshëm me rregjistrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve nga sistemet që përdorin Banka e Shqipërisë dhe Bankat e tjera. Si rezultat i këtij ndryshimi rregjistrimi i zërit “Të ardhura dhe shpenzime nga bankat e nivelit të dytë” në

llogarinë e unifikuar të thesarit “Depozitë qeverie”, rregjistrohet në Ministrinë e Financave, vetëm për diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve, ndërsa në sistemet regjistruese të bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë, “Të ardhura dhe shpenzime nga bankat e nivelit të dytë” për llogarinë e qeverisë “Depozitë qeverie” bëhen jo për diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve, por në bazë cash-i si për të ardhurat dhe shpenzimet, *trajtuar më hollësisht në faqe 27-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të thesarit dhe të menaxhimit të sistemit, të hartohet një skedul për projektimin, dizenjimin në sistemin infomatik të qeverisë për njohjen dhe rregjistrimin e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e aktiveve, në mënyrë që edhe të ardhurat të njihen dhe rregjistrohen si njohja dhe rregjistrimi i shpenzimeve në çastin e ndodhjes, pavarësisht nga data e arkëtimit të tyre.

Menjëherë dhe vazhdimisht

8. Nga auditimi i vlerësimit të sistemeve të kontrollit në çeljen dhe konfirmimin e llogarive speciale në Bankën e Shqipërisë, jashtë llogarisë së Unifikuar të Thesarit “Depozitë Qeverie”, rezultoi se:

a. Për vitin 2015, sipas kërkesës së Ministrisë së Financave, janë konfirmuar vetëm një herë në fund të vitit, 5 llogari “Depozita speciale të qeverisë”, të çelura në Bankën e Shqipërisë. Konfirmimi i tyre ka rezultuar sa gjendja në Bilancin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2015.

b. Depozitat speciale, të çelura në Bankën e Shqipërisë, janë të çelura për çdo projekt të veçantë. Në rastin e kërkesës së informacionit mbi balancat e këtyre llogarive, Ministria e Financës i kërkon informacion Bankës së Shqipërisë për balancat e llogarive të projekteve. Më pas balancat i dërgohen audituesit të pavarur, po me vlerat që ka konfirmuar Banka e Shqipërisë.

Drejtoria e Përgjithëshme e Thesarit/Drejtoria e Operacioneve Monetare, nuk i mban dhe regjistron llogaritë “Depozita speciale të qeverisë” si llogarinë e Unifikuar të thesarit “Depozitë qeverie”, por bën vetëm konfirmimin e shifrave që dërgon Banka e Shqipërisë me kërkesë të saj, *trajtuar më hollësisht në faqe 27-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga strukturat drejtuese të këtij institucioni dhe në veçanti strukturat drejtuese të Thesarit në këtë institucion, si përgjegjëse për mbajtjen e llogarive të shtetit dhe përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore të zbatimit të buxhetit, të mbajnë dhe të kërkojnë për llogaritë “Depozita speciale të qeverisë”, rregjistrimin dhe konfirmimin e tyre si për llogarinë e Unifikuar të Thesarit “Depozitë qeverie”.

Menjëherë dhe vazhdimisht

9. Nga auditimi i procedurave të çeljeve të llogarive speciale për Financimet e huaja, konstatohet se Ministria e Financave nuk ka të dhëna të plota, kryesisht për grantet, pasi informacioni që ajo bazohet në gjenerimin e të dhënave varet tërësisht nga saktësia dhe dëshira e institucioneve për të raportuar, si dhe komunikimit që bëhet nga Sektori i TSA, me kërkesën për raportime nga këto institucione, por që rezulton i pa finalizuar me raportim.

Nga auditimi i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në MMSR rezulton i raportuar në MF vetëm projekti “Modernizimi i Asistencës Sociale”, me fonde të Bankës Botërore, si dhe TVSH e Taksë doganore, paguar për Projektin RISI, Albania dhe Projektin GIZ, dhe nuk ka të raportuar asnjë nga grantet e përfituara nga donatorët e ndryshëm megjithëse ato janë në miliona Euro, në kundërshtim kjo me pikën 20 të VKM nr.775 datë 24.09.2010, ku përcaktohet se: *“Ministritë/institucionet qendrore dhe vendore, kur përfitojnë ndihmë financiare apo materiale nga fondacione, shoqata, ndërmarrje, individë të ndryshëm etj., detyrohen që menjëherë, të raportojnë në Ministrinë e Financave. Mos raportimi në kohë*

ngarkon me përgjegjësi drejtuesin e institucionit dhe i jep të drejtë Ministrisë së Financave të rishikojë deri në pakësimin e fondeve buxhetore të kushtëzuara për vlerën e ndihmës së përfituar”.

Gjithashtu pika 21 përcakton: *“Ministritë/institucionet qendrore dhe vendore, kur përfitojnë për projekte të ndryshme hua, grante apo ndihma materiale, rregullisht një herë në muaj, sipas afateve, raportojnë të dhënat në Ministrinë e Financave.”*

Nga auditimi i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në MMSR rezultoi se grantet dhe projektet, nuk raportohen dhe nuk rregjistroheshin në fund të vitit si të hyra apo si pjesë e buxhetit faktik vjetor, pra nuk kryhej asnjë veprim ekonomik rregjistruar, pavarësisht se grantet janë të hyra në Buxhetin e Shtetit në ndihmë dhe mbështetje të shtetit Shqiptar, ku në bazë të informacionit të MMSR, Ministria e Financave ndjek, regjistron dhe raporton të gjitha transaksionet që lidhen me huat dhe grantet, referuar VKM nr. 775 datë 24.09.2010, ku realizimi i huave dhe granteve nga jashtë do të jenë pjesë përbërëse e buxhetit faktik vjetor, si dhe do të ndiqet procedura e parashikuar në pikën 18 të tij ku thuhet: *“Të gjitha të ardhurat nga huat dhe grantet do të regjistrohen si të hyra në “Llogarinë qendrore të thesarit”, në Bankën e Shqipërisë, nëpërmjet tranzitimit në llogaritë speciale të hapura në emër të çdo projekti pranë Bankës së Shqipërisë. Huat dhe grantet që lëvrohen në natyrë, për shkak se pagesa e tyre bëhet drejtpërdrejt nga llogaritë e huadhënësit, do të regjistrohen si të hyra në buxhet, në bazë të njoftimeve të pagesave nga huadhënësi/dhuresi dhe të konfirmuara nga institucioni përfitues, sipas procedurave që do të përcaktojnë për këtë qëllim Ministria e Financave”, trajtuar më hollësisht në faqe 27-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të kërkohet në mënyrë të menjëhershme informacion dhe të dhëna të detajuara për çdo financim të huaj nga çdo Institucion, të kryhet rakordim mes tyre, me qëllim që të gjitha të ardhurat nga huat dhe grantet të regjistrohen si të hyra në “Llogarinë qendrore të thesarit”, dhe kjo llogari të ketë të dhëna të besueshme dhe të plota, në ushtrim, kjo, të kompetencave që i janë dhënë nga VKM nr. 775, datë 24.09.2010, lidhur me detyrimin për raportim që kanë institucionet për financimet e huaja dhe në mënyrë të veçantë për MMSR, duke rritur shkallën e përgjegjësisë me të cilën ngarkohet çdo institucioni në rast të mos raportimit dhe respektimit të afateve për raportim deri në penalizim të personave përgjegjës, për të mos mbetur në kuadrin e komunikimit elektronik apo dëshirën e institucioneve për raportim, duke i lënë si deri më tani jashtë monitorimit financime të cilat i akordohen Shtetit Shqiptar.

Menjëherë

10. Nga verifikimi mbi listën e Nëpunësve Autorizues dhe atyre zbatues të institucioneve qendrore dhe varësie, të cilët autorizojnë kryerjen në thesar të pagesave për çdo transaksion nga institucioni i tyre dhe rezultoi se përgjithësisht ishte respektuar përcaktimi ligjor me pikën 1 të nenit 12 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” të ndryshuar, por u konstatua se vetë MF nuk e respektonte pasi:

Nga auditimi konstatohet se, me shkresën nr. 4630, datë 4.04.2016 Nëpunës Autorizues i Ministrisë së Financave është caktuar për një periudhë të përkohshme kohe zj. I.M, aktualisht në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Borxhit Publik.

Ky caktim i Nëpunësit Autorizues të Ministrisë së Financave bie ndesh me pikën 1 të nenit 12 të Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” të ndryshuar, ku përcaktohet qartësisht se: *“Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat të njësisë publike, në varësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose zotëron diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike.”*

Mbështetur në sa më sipër, do të duhej që Nëpunës autorizues i Ministrisë së Financave të jetë Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Juridike, pozicion i cili ka në varësi direkte Drejtorinë e Financave. Caktimi i përkohshëm është argumentuar për shkak të vakancës në këtë pozicion, por një përcaktim i tillë, nuk respekton linjën vertikale të hierarkisë, në këtë mënyrë detyrat e Nëpunësit Autorizues duhet të përmbushen nga Nëpunësi i Parë Autorizues deri në plotësimin e vakancës.

Nga auditimi konstatohet se, mbështetur në rolin e Nëpunësit Autorizues zj. I.M. i delegohet edhe kompetenca e Titullarit të Autoritetit Kontraktor me urdhrin nr.64 datë 23.05.2016, ku në përmbajtjen e urdhrin është parashikuar si bazë ligjore shkresa nr.4630, datë 4.4.2016, “Për caktimin e nëpunësit autorizues të Ministrisë së Financave”. Ky akt administrativ nuk mund të shërbejë si mbështetje ligjore për nxjerrjen e një akti tjetër administrativ me objekt delegimi kompetencash.

Në rastin konkret, në bazë të ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin është Nëpunësi i parë Autorizues, përgjegjës për monitorimin e progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në sektorin publik.

Në kushtet kur Nëpunësi i parë Autorizues është në detyrë dhe ushtron funksionet e tij, delegimi i kompetencave të titullarit të AK tek Drejtori i Përgjithshëm i një prej Drejtorive të Përgjithshme të Ministrisë së Financave bie ndesh me legjislacionin e cituar mësipër. Kjo kompetencë, ose mbahet nga vetë Ministri i Financave, ose zbret vetëm një nivel më poshtë që është Sekretari i Përgjithshëm/ Zv/Ministër. Ky delegim bënë nul gjithë procedurat e prokurimit.

E njëjta situatë evidentohet dhe në **MMRS**, ku nëpunësi zbatues është Drejtori i Integritit, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 12 të Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar, ku përcaktohet qartësisht se: *“Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat të njësisë publike, në varësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose zotëron diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike.”* trajtuar më hollësisht në faqe 10-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandoj:

Ministria e Financave të marrë masa të menjëhershme me qëllim respektimin e linjës vertikale të hierarkisë, në këtë mënyrë detyrat e Nëpunësit Autorizues duhet të përmbushen nga Nëpunësi i Parë Autorizues deri në plotësimin e vakancës **dhe në zbatim të** pikës 1 të nenit 12 të Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar, ku përcaktohet qartësisht se: *“Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat të njësisë publike, në varësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose zotëron diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike”.*

Të revokojë Urdhrin nr.64, datë 23.05.2016, ku Nëpunësit Autorizues i delegohet edhe kompetenca e Titullarit të Autoritetit Kontraktor mbështetur kjo në shkresën nr. 4630, datë 4.04.2016, “Për caktimin e nëpunësit autorizues të Ministrisë së Financave”, pasi ky akt administrativ nuk mund të shërbejë si mbështetje ligjore për nxjerrjen e një akti tjetër administrativ me objekt delegim kompetencash.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Bazuar në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “ç” të Kreut X “Disiplina në Shërbimin Civil” të ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, Vendimit të KM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, Kreu II “Procedura disiplinore”, si dhe Udhëzimit të Departamentit të Administratës Publike nr. 1, datë 02.04.2014 “Elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, si dhe referuar përshkrimit të punës dhe detyrave që mbulojnë në strukturat përkatëse, *i rekomandoj Titullarit të Ministrisë dhënien e masës disiplinore:*

“Largim nga shërbimi civil” për:

1. Znj. M.P., me detyrë Drejtore e Drejtorisë Operacionale të Thesarit, pasi:

Nga auditimi konstatohet se nuk ekzistojnë në asnjë rast gjurmët e auditimit, lidhur me miratimin e likuiditetit, miratimin e mënyrës së llogaritjes së tij, kërkesat për likuiditet nga Drejtoria e Borxhit nuk janë të dokumentuara dhe të rakorduara.

Në asnjë rast nuk kemi shkëmbim zyrtar shkresor brenda Drejtorisë së thesarit, sidomos për ato raste të cilat është i nevojshëm miratimi dhe konfirmim i shifrave të çeljeve vjetore, mujore apo ditore, i nivelit të likuiditetit etj, në kundërshtim me nenin 24 të Kodit Etik i Sietemit të Thesarit, miratuar me shkresën nr. 117/2, datë 09.06.2011 dhe të kërkesave të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, “kontrolli i brendshëm”, qëllimi i të cilit është krijimi i një sistemi të varur kontrolli të brendshëm, i cili siguron që informacioni i gjeneruar nga Thesari të jetë i saktë dhe i besueshëm, që transaksionet të jenë të autorizuar dhe mjetet të jenë të menaxhuara me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet. Krijimi i këtyre procedurave ndihmon në zbulimin e hershëm dhe pakësimin e risqeve të lidhura me procedurat e Thesarit dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Nga auditimi i pagesave u konstatua se, në muajin janar 2016 janë kryer pagesa gjithsej në shumën 6 miliardë lekë, ose 7.5% të totalit të pagesave vjetore, të cilat kanë kaluar për llogari të vitit 2015, referuar Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 33, datë 28.12.2015 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2015”, por nga auditimi i këtyre pagesave në sistemin informatik të qeverisë (SIFQ) rezulton se, janë kryer pagesa jashtë afatit të përcaktuar, pra të regjistruara dhe të likuiduara në vitin 2016, të cilat çojnë në denatyrimin e konceptit “buxhet vjetor” dhe raportimit financiar vjetor. Konkretisht, rezultuan se janë të tilla 25 transaksione në total në vlerën 79.5 milion lekë, ku peshën më të madhe e zënë veprimet në Degën e Thesarit Tiranë, në Degën e Thesarit Elbasan, në Degën e Thesarit Durrës, etj., të cilat janë përfshirë në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, pavarësisht se janë regjistruar jashtë periudhës 1 janar-31 dhjetor.

Nga auditimi u konstatua se, në llogarinë 231 “Shpenzime për rritjen e AQT” kemi pagesave të menjëhershme me lidhjen e kontratës në 18 raste në vlerën 695 milion lekë, (të cilat kryesisht i përkasin ARSH-s) janë likuiduar situacione të cilat janë pretenduar si punime të kryera, por në fakt, ato nuk mund të jenë të tilla, pasi diferenca kohore midis lidhjes së kontratës dhe likuidimit të situacionit është edhe vetëm 3 ditë, ku teknikisht është e pamundur, referuar manualeve teknike të ndërtimit, si dhe në kundërshtim me Ligjin e prokurimeve dhe ligjin për Buxhetin e Shtetit.

Nga auditimi u konstatua se, në sistem evidentohen raste të çlirimit të garancisë së punimeve (5%) nga llogaria 466 “Garanci të punimeve” në një afat të shkurtër kohor, pasi është kryer marrja në dorëzim e punimeve, në kundërshtim me legjislacionin për punimet e ndërtimit, dhe kontratatave, i cili përcakton se, garancia e punimeve çlirohet mbas një viti apo dy viteve në rastin e punimeve në segmente rrugore, me marrjen e certifikatës së defekteve gjatë periudhës së garancisë lëshuar nga institucioni përkatës (me hollësisht aneksi nr.2, bashkëngjitur Raportit përfundimtar të Auditimit).

Nga auditimi i *diferencave të raportimit për të ardhurat e kaluara nga Bankat e nivelit të dytë* dhe raportimit që bëjnë këto banka në të dy institucionet (MOF dhe BOA), gjatë konfirmimit të këtij zëri si pjesë e llogarisë së unifikuar të thesarit “Depozitë Qeverie”, rezultoi:

Për vitin 2015, diferenca e raportimit e të ardhurave të njohura dhe kaluara nga Bankat e nivelit të dytë, është në vlerë **1,099,228.78 mijë lekë**

Nga auditimi mbi procedurat e monitorimit financiar, evidentimit dhe menaxhimit të gabimeve në regjistrimin e transaksioneve, konstatohet se për vitin 2015, kemi 1893 raste nga degët e thesarit nëpër rrethe.

Në total numrin më të madh të rasteve me gabime e zë Tirana me 62% rasteve, Berati me 2.7%, Durrësi me 5.8%, Fieri me 2.4%, Gjirokastrë me 2.9%, Dibër me 2.5%, Sarandë me 3.1%, Mallakastër me 2.3 %, ndërsa degët e tjera rezultojnë me gabime nën 2% të rasteve.

Risku i gabimit është në nivel të lartë dhe kjo është shoqëruar me kosto shtesë, pasi për çdo transaksion të kryer gabim për faj të punonjësve të Thesarit apo dhe institucionit, i paguhet Bankës respektive komision bankar, referuar rasteve të cilat janë të shumta për vitin 2015, gabimet kryesisht rezultojnë në, nr llogarie, përskrime të pagesës etj, si dhe nuk evidentohet qartë se gabimi i kujt është, i subjektit apo i punonjësit të thesarit, por rezultati është se faturimi i pagesës së komisionit gjithmonë është në ngarkim të Ministrisë së Financës dhe MF ja përcjell Degës përkatëse të thesarit dhe kjo e fundit Institucionit.

Për sa ndodh më sipër, nuk ka asnjë analizë për të përcaktuar dhe ndarë gabimin, në një gabim të mundshëm njerëzor, apo risk operacional i trajnimit të paket të stafit, si dhe ndarja e përgjegjësisë për pagesën e komisionit, faturimi i të cilës duhet ti bëhet shkaktarit të saj,

2. Znj. I.R., me detyrë, Përgjegjëse e Sektorit të TSA-s fondeve speciale dhe financimeve të huaja, pasi:

Nga auditimi i procedurave të çeljeve të llogarive speciale për Financimet e huaja, konstatohet se MF nuk ka të dhëna të plota, kryesisht për grantet, pasi informacioni që ajo bazohet në gjenerimin e të dhënave varet tërësisht nga saktësia dhe dëshira e institucioneve për të raportuar, si dhe komunikimit që bëhet nga Sektori i TSA, me kërkesën për raportime nga këto institucione, por që rezultoi i pa finalizuar me raportim.

Nga auditimi i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në MMSR rezultoi i raportuar në MF vetëm projekti “Modernizimi i Asistencës Sociale” me fonde të Bankës Botërore, si dhe TVSH dhe Taksë doganore, paguar për Projektin RISI Albania dhe Projektin GIZ, dhe nuk ka të raportuar asnjë nga grantet e përfituara nga donatorët e ndryshëm megjithëse ato janë në miliona Euro, në kundërshtim kjo me pikën 20 të VKM nr.775 datë 24.09.2010, ku *“Ministritë/institucionet qendrore dhe vendore, kur përfitojnë ndihmë financiare apo materiale nga fondacione, shoqata, ndërmarrje, individë të ndryshëm etj., detyrohen që menjëherë, të raportojnë në Ministrinë e Financave. Mos raportimi në kohë ngarkon me përgjegjësi drejtuesin e institucionit dhe i jep të drejtë Ministrisë së Financave të rishikojë deri në pakësimin e fondeve buxhetore të kushtëzuara për vlerën e ndihmës së përfiturar”*.

Gjithashtu pika 21 përcakton: *“Ministritë/institucionet qendrore dhe vendore, kur përfitojnë për projekte të ndryshme hua, grante apo ndihma materiale, rregullisht një herë në muaj, sipas afateve, raportojnë të dhënat në Ministrinë e Financave.”*

-Nga auditimi i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në MMSR rezultoi se, grantet dhe projektet, nuk raportohen dhe nuk regjistroheshin në fund të vitit si të hyra apo si pjesë e buxhetit faktik vjetor, pra nuk kryhej asnjë veprim ekonomik regjistruar, pavarësisht se grantet janë të hyra në Buxhetin e Shtetit në ndihmë dhe mbështetje të shtetit Shqiptar, ku në bazë të informacionit të MMSR, Ministria e Financave ndjek, regjistron dhe raporton të gjitha transaksionet që lidhen me huat dhe grantet, referuar VKM nr. 775, datë 24.09.2010, ku realizimi i huave dhe granteve nga jashtë do të jenë pjesë përbërëse e buxhetit faktik vjetor si dhe do të ndiqet procedura e parashikuar në pikën 18 të tij ku *“Të gjitha të ardhurat nga huat dhe grantet do të regjistrohen si të hyra në “Llogarinë qendrore të*

thesarit”, në Bankën e Shqipërisë, nëpërmjet tranzitimit në llogaritë speciale të hapura në emër të çdo projekti pranë Bankës së Shqipërisë. Huat dhe grantet që lëvrohen në natyrë, për shkak se pagesa e tyre bëhet drejtpërdrejt nga llogaritë e huadhënësit, do të regjistrohen si të hyra në buxhet, në bazë të njoftimeve të pagesave nga huadhënësi/dhuruesi dhe të konfirmuara nga institucioni përfitues, sipas procedurave që do të përcaktojnë për këtë qëllim Ministria e Financave.”

Gjithsesi, për sa më sipër, nisur dhe nga specifikat e institucionit, është në kompetencë të Titullarit të Ministrisë, vlerësimi dhe dhënia e masave disiplinore për punonjësit e mësipërm, bazuar dhe në kërkesat e nenit 59 të ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014 dhe Udhëzimit të Departamentit të Administratës Publike nr. 1, datë 02.04.2014 “Elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R